



BASHKIA KAMEZ

RELACION HIDROLOGJIK

Objekti: NDERTIM I RRUGEVE BASHKIA KAMEZ

Relatoi:

Ing. Hajredin MURGU

Top. Ramadan HYSA

Ark. Ardit GJONAJ

DREJTORI E P.I-se

Ing. Flora MUÇA

MIRATOHET

RAKIP S U L I

K R Y E T A R

Tirane 2022

1. Te Pergjitheshme

I.2 Rrezatimi diellor dhe diellzimi

I.3 Regjimi i temperaturës së ajrit

I.4 Evapotranspiracioni

I.5 Reshjet atmosferike

1.6 Era

I.7 Lageshtia e ajrit

2. Lumi Erzen

2.1. Vecorite hidrografike dhe hidrologjike te Lumit Erzen

2.2 Vecorite klimatike te pellgut te Lumit Erzen

2.3 Vecorite hidrogjeologjike

3. Lumi i Ishimit

3.1 Konsiderata te pergjitheshme

3.2. Vecorite Hidrografike

4. Lumi i Lanes

4.1 Konsiderata te pergjitheshme

4.2 Vecorite klimatike

4.3 Vecorite fiziko-kimike

5. Faza e Projektimit

Te pergjithshme

Ndodhet në Njësinë Administrative Kamëz, qarku Tirane, në pjesën veri-perëndimore të Tiranës. Vendodhja e zones në studim, është një zonë e ndërtuar kryesisht pas viteve 1990, ku mbizotërojnë ndërtime pallatesh 5 kateshe me tulla silikate dhe pallate parafabrikat, te miksuara nga banesa 1-3 kateshe .

Pershkrimi i gjendjes ekzistuese

Gjendja e rrugëve në këtë bllok paraqitet pothuajse pa asnjë parameter inxhinierik. Distanca midis pallateve nga njëra tjetra është e konsiderueshme, gjë që bën të evidentueshme një gjendje kaotike të organizimit të makinave. Pothuajse të gjitha rrugët e brendëshme të bllokut janë të shtruara me shtresë betoni të varfër, ndërsa pjesa tjetër janë totalisht pa asnjë shtresë rrugore duke mbizotëruar gropat e shumta në të cilat në periudhë shirash bëhen pothuajse të pakalueshme, gjë që krijon një gjendje kaotike trafiku dhe shumë vështirësi në kalueshmëri. Në shumë pjesë të bllokut, rrugët paraqiten me dëmtime të shumta dhe me mungesa të elementëve të nevojshëm për funksionimin e tyre, si dhe ka mungesa të evidentueshme, si psh ndriçimi, trotualet, hapësirat e gjelbra etj. Trotuarët ekzistojnë pjesërisht të cilat janë ndërtuar nga vetë subjektet private ndërtuese të pallateve të shtruara me beton, duke mos patur një uniformitet dhe standart të përshtatshëm. Ndriçimi në bllok, pothuajse nuk ekziston dhe atje ku është prezent, është i mundur nëpër shtylla betoni të cilat shërbejnë për shpërndarjen e linjave të tensionit të ulët-mesëm-lartë dhe shpërndarjes së linjave të internetit. KUZ dhe KUB janë ndërtuar nga subjektet ndërtuese të pallateve dhe kërkojnë verifikim dhe ndërhyrje nga ndërmarrjet kompetente për funksionimin e tyre. Në disa pjesë të bllokut, ka shumë pak mundësi aksesit midis rrugëve të bllokut me njëra tjetrën si dhe shumë rrugë janë pa “krye”.

I. Veçoritë klimatike

Karakteristikat hidrologjike të një rajoni përcaktohen në një shkallë të madhe prej *topografisë, gjeologjisë* dhe kryesisht prej *klimes* së tij. *Topografia* është e rëndësishme për shkak të ndikimit të saj mbi reshjet, mbi zhvillimin e liqeneve dhe zonave kenetore dhe mbi intensitetin e rrjedhjes. *Gjeologjia* ndikon gjithashtu mbi topografinë dhe gjithashtu jep informacion mbi zonën e ujërave nentokesore ku uji leviz ngadale mbi akuiferin drejt lumit apo detit. *Klima* e një zone, që shpjegon kushtet e motit në këtë zonë si mesatare gjatë një periudhe të gjatë kohe, varet nga pozicioni gjeografik i saj në sipërfaqen e tokës. Faktoret meteorologjik janë rrezatimi diellor, temperatura, presioni atmosferik, lagështia dhe era. Rëndësia e këtyre qëndron në faktin që ato ndikojnë drejtpërdrejt mbi perseritjen dhe ndryshueshmërisë së reshjeve, avullimit dhe transpirimit.

Zona ku parashikohet të bëhet ky projekt bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare fushore në zonën qendrore.

Për të plotësuar më mirë analizën klimatike të këtij pellgu, krahas të dhënave për stacionet e Tiranës dhe të Durrësit (me lartësi përkatesisht 126.7m dhe 14.6 m mbi nivelelin e detit), janë marrë në konsideratë edhe seritë klimatologjike të stacioneve të cilat bëjnë pjesë në pellgjet ujembledhës të kësaj zone, gjithashtu janë marrë të dhëna nga burime meteorologjike si dhe nga interneti.

Rrezatimi diellor dhe diellzimi

Rrezatimi diellor

Rrezatimi diellor është burimi kryesor i energjisë, përcakton motin dhe klimën. Transmetimi i energjisë drejt oqeanit ndodh nepermjet rrezatimit, percjellshmerise dhe konveksionit.

Për të dhënat e këtij treguesi i kemi referuar vetëm stacionit ne Tirane dhe Durres dhe janë analizuar të dhënat e Atlasit Klimatik të Republikës së Shqipërisë (Tiranë 1988). Në vlerat e këtij treguesi rol të rëndësishëm luan pozicioni topografik, të hapur në drejtim të perëndimit, si dhe konfiguracioni i relievit. Zgjatja faktike e diellzimit në mesatare vjetore është 2617 orë 45, për janarin 125 orë, korrikun 350 orë. Zgjatja relative e diellzimit është për janarin (45%), korrikun (80%) dhe vjetore 60%. (Referuar Atlasit Klimatik të R.Shqipërisë 1988, për periudhën 1956-1980).

Nga të dhënat rezultojnë se mesatarja ditore e rrezatimit të përgjithshëm diellor arrin vlerën ne korrik 6781 Kwh/m² per Tiranen dhe 6802 Kwh/m² per Durresin.

Tab.1. Shpërndarja sasiore e orëve me diell

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes. Ditore
Tirane	1830	2468	3346	4468	5602	6477	6781	5990	4619	3229	1981	1546	4036
Durres	1840	2559	3504	4693	5730	6557	6802	6029	4631	3190	2018	1567	4115

Burimi i Hidro-Meteorologjise




Fig.1. Shpërndarja sasiore e orëve me diell

Ne table dhe figure janë dhene vlerat mesatare mujore te (dhe vjetore) te numerit te diteve me diell per dy stacione per te cilat u gjeten te dhena. Per sa i perket tendencies mujore, muaji me vlere me te ulet eshte Prilli, i cili varijone nga 4.6 dite ne Tirane dhe 5.5 dite ne Durres, kurse muaji me vlere me te larte eshte Korriku, i cili varion nga 17.7 dite ne Tirane ne 19.3 dite ne Durres.

Tab.1.2.2 Shpërndarja sasiore e diteve me diell

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.
-------	-------	--------	------	-------	-----	---------	--------	-------	---------	-------	--------	---------	------

													Vjetore
Tirane	6.5	5.8	5.5	4.6	5.3	7.8	17.7	17.6	13.4	9.6	6.1	6.1	106.0
Durres	6.7	6.3	5.9	5.5	7.2	9.9	19.3	18.2	13.8	10.4	6.0	5.8	115.0




Fig.2. Shpërndarja sasiore e diteve me diell

Kjo zonë, ashtu si edhe në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh i orëve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2400 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe atë më të ulët në Janar me 110 orë.

Në Tabelën 1.2.2 dhe Figurën 1.2.2 janë dhene vlerat mesatare mujore (dhe vjetore) e numrit të ditëve me re për dy stacionet. Ne Tirane kemi mesatarisht 97.8 dite me diell dhe ne Durres kemi mesatarisht 84.4 dite me diell ne vit.

Tab.1.2.2 Shpërndarja sasiore e diteve me re

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes. Vjetore
Tirane	12.1	12.5	12	11.6	7.3	4.2	1.6	1.8	3.6	7.1	11.9	12.1	97.8
Durres	11.5	10.4	10.3	9.6	5.9	3.3	0.8	1.5	3.4	6	10.1	11.6	84.4

Në lidhje me trendin mujore, muaji me vlerat më të ulët është Korriku, e cila varijon nga 0,8 ne Durres në 1,6 në Tiranë, ndërsa muaji me vlerat më të larta është Janari, e cila varijone nga 11.5 ne Durres në 12,1 në Tiranë.




Fig.3. Shpërndarja sasiore e diteve me re

I.3 Regjimi i temperaturës së ajrit

Temperatura percaktohet si mase e nxehtesise se ndjeshshme, dhe dhe eshte shume e rendesishme sepse ndikon ne madhesine intesitetin e avullimit, transpirimit, ne borteshkrijen si dhe mbi formen e reshjeve. Vrojtimi i temperatures behet me ane te termometrave normal, maksimal dhe minimal. Temperatura minimale gjate dites ndodh zakonisht para lindjes se diellit ndersa ajo maksimale $\frac{1}{2}$ deri ne 3 ore pasi dielli te kete arritur lartesine maksimale. Termat qe lidhen me temperature dhe qe perdoren shpesh ne hidrologji jane: temperature mesatare ditore, temperature mesatare mujore si dhe temperature mesatare vjetore. Temperatura peson ndryshime ne hapsire edhe me lartesine, megjithate kushtet mesatare duhet te percaktohen ne nje kohe dhe ne nje vend te caktuar.

Siç e përmendëm dhe më sipër, pozicioni gjeografik dhe format e ndryshme te relievit reflektohen ndjeshëm në kushtet klimatike të zonës, dhe sidomos në vlerat e temperaturave të ajrit. Nje perfytyrim te pergjithshem te regjimit termik te nje zone jep shqyrtimi i vlerave mesatare vjetore te temperatures.

Konkretisht, duke iu referuar stacioneve meterologjike perkatese temperatura mesatare vjetore per Tiranen eshte 15.1°C temperatura minimale eshte -10.4°C dhe makimale 41.5°C ndersa per Durresin temperatura mesatare eshte 16°C temperatura minimale eshte -6.2°C dhe maksimale 39°C . Keto jane vlera mesatare te nxjerra nga nje seri e gjate vrojtimesh (30, 40vjet) te pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise referuar literatures (Remenieras.R, Hidrology de l'Engineur, Eurolles, Paris).

Per te evidentuar ecurine brendavjetore te ajrit le t'i referohemi tabl.1.1 ne te cilen jepen vlerat mesatare te temperatures se ajrit per çdo muaj ne zonen e Tiranës dhe te Durresit.

Tab. I.3.1 Temperatura mesatare mujore e ajrit per Tiranen dhe Durresin

Emri	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Tirane	6.7	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2
Durres	8.2	9.2	10.9	14	18.1	21.8	23.8	23.8	21.1	17.3	13.4	10

Siç shihet temperatura mesatare ka nje ecuri normale me nje maksimum ne muajt e veres dhe minimum ne muajt e dimrit. Shif fig.I.1.1. Keshtu muaji më i ftohte i vitit eshte Janari ku temperaturat mesatare eshte 6.7°C ne Tirane si dhe 8.2°ne Durres. Ndersa muaji me i ngrohte eshte muaji korrik dhe gusht me vlere te temperatures mesatare 23.8°C si ne Tirane edhe ne Durres .




Figure 4. Ecuria brendavjetore e temperatures mesatare ajrit

I.4 Evapotranspiracioni

Në Tabelë1.4 dhe Figurën 1.4.1 jane dhene vlerat mesatare mujore (dhe vjetore), te evapotranspiracionit potencial, e llogaritur nga formula Penman për dy stacionet ku ky lloj i të dhënave është në dispozicion. Vlera mesatare vjetore është 77 mm nëTirane, ndërsa maksimumi është 90 mm në Durrës. Në lidhje me trendet mujore, muaji me vlerat më të ulët është Dhjetori, e cila varijone nga 11 mm në Tiranë dhe 23 mm në Durrës, ndërsa muaji me vlerat më të larta është Korrik, e cila varijone nga 178 mm në Tirane ne 191 mm në Durrës.

Tab. Evapotranspirimi mesatare mujore i ajrit per Tiranen dhe Durresin

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes vjetore
Tirane	14	23	49	73	109	152	178	157	88	49	21	11	77
Durres	22	32	62	92	122	166	191	169	102	64	35	23	90




Fig.5.Evapotranspirimi mesatare mujore i ajrit per Tiranen dhe Durresin

I.5 Reshjet atmosferike

Reshjet mesatare vjetore është 1219 mm/vit ne Tirane dhe sasia mesatare e reshjeve është 931.1 mm/vit. Po te studiojme shperndarjen brendavjetore te reshjeve ne kete zone verejme qe kjo shperndarje eshte e pabarabarte ne periudha te ndryshme te vitit. Sasia me e madhe e reshjeve bie gjate gjysmes se ftohte te vitit rreth 70%, nderkohe qe gjate muajve te veres sasia e tyre eshte me e vogel, rreth 30%. Kjo shperndarje lidhet me veprimtarine e theksuar ciklonare gjate muajve te ftohte te vitit, e cila shoqerohet me mot me vranesira dhe reshje te bollshme. Ne tabelen e meposhteme jepen sasite per çdo muaj te reshjeve qe bien ne kete zone. Keto vlera jane rezultat i perpunimit te serive shumevjeçare te reshjeve (30,40 vjet), seri vrojtimesh e pranuar nga Organizata Boterore e Meteorologjise per kryerjen e studimeve klimatike te nje rajoni te dhene.

Tab. I.5.1 Sasia mujore shumevjeçare e reshjeve

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes vjetore
Tirane	129.4	118.9	121	103.1	88.2	66.8	40.8	50.5	83.2	107	164.2	146.1	1,219.20
Durres	110.6	91.4	95.2	76.2	50.8	38.7	23.9	34.8	62.5	101.1	132.9	113	931.1




Fig. 6 Ecuria brenda vjetore e reshjeve

Siç shihet nga te dhenat e tabelës 1.5.1 dhe nga paraqitja grafike fig. I.5.1, shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka formën e “U” që shpreh qartë regjimin mesdhetar të reshjeve. Një tregues i rëndësishëm dhe i dobishëm për qëllime hidroteknike dhe urbanistike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale për intervale të tjera kohor për periudha të ndryshme përsëritje. Duke u mbështetur në seritë e vlerave maksimale të reshjeve të rena gjatë 24 orëve janë llogaritur vlerat e pritura të intensiteteve të reshjeve për periudha të ndryshme përsëritje.

VENDI I MATJES	Kohëzgjatja e reshjeve [orë]	Kohëzgjatja e reshjeve [orë]	Siguria (shpeshësia) [%] dhe në RP [vjet]					
			1	2	5	10	20	50
			100	50	20	10	5	2
			X [mm]	X [mm]	X [mm]	X [mm]	X [mm]	X [mm]
DURRËS PORT	24	24	199	178	151	130	108	74
	12	12	165	147	124	106	87	59
	6	6	127	115	98	85	71	50
	2	2	94	85	73	64	54	39
	1	1	73	66	57	50	43	32
	0.50 (30 minuta)	0.5	56	50	43	38	32	24
	0.33 (20 minuta)	0.3333	44	40	35	31	27	20
	0.1667 (10 minuta)	0.1667	31	28	25	22	19	15
TIRANË	24	24	178	161	140	122	105	78
	12	12	161	144	123	106	88	62
	6	6	126	114	97	84	71	51
	2	2	89	82	69	60	51	38
	1	1	58	53	46	42	36	28
	0.50 (30 minuta)	0.5	43	40	35	31	28	22
	0.33 (20 minuta)	0.3333	38	35	30	27	24	19
	0.1667 (10 minuta)	0.1667	32	29	25	22	19	14

Tab. Intensiteti i reshjeve për siguri të ndryshme

Konkretisht (për stacionin në Tiranë), brenda 24 orëve pritet të bien 181 mm shi për sigurinë 1% (periudha e përsëritjes 1 herë në 100 vjet), ndërsa për sigurinë 10% (periudha e përsëritjes 1 herë në 10 vjet) pritet të bien 125 mm.

Ndërsa për stacionon e Durrësit në port, brenda 24 orëve pritet të bien 199 mm shi për sigurinë 1% dhe për sigurinë 10% (periudha e përsëritjes 1 herë në 10 vjet) pritet të bien 130 mm.

1.6 Era

Nisur nga te dhenat e Insitutit Hidrometerologjik konkretisht ne Literaturen (Klima e Shqiperise Era tab.3) marrim keto te dhena sa i perket rastisjeve shumevjeqare te shpejtesise se eres sipas ketyre se eres sipas ketyre drejtimeve:

Rastisja shumevjeqare e shpejtesise se eres sipas drejtimeve neTirane

Drejtimi i eres	Shpejtesia Mesatare e Eres m/s	Rastesia
V	2.4	4.5
VL	1.9	4
L	1.5	8.7
JL	2.4	14.4
J	2.3	3.3
JP	2.8	3.2
P	2.6	4.5
VP	2.5	16.6

Tab.I.6.1 Rastisja shumevjeqare e shpejtesise se eres sipas drejtimeve neTirane




Fig.7 Trandafili I Ererave. Vendmatja Tirane

Nga trandafili i ererave ne fig.7 vihet re se mbizoterojne ererat e sektorit Perendimor kokretisht ererat e drejtimit P dhe PJ.

Rastisja shumevjecare e shpejtesise se eres sipas drejtimeve ne Durres Port

Drejtimi I eres	Shpejtesia Mesatare Eres m/s	Rastesia
V	2.8	28.5
VL	2.2	4
L	2.6	3.8
JL	3.8	21.3
J	6	7.5
JP	5.6	6.2
P	4.6	13
VP	3.4	8.8

Tab.Rastisja shumevjecare e shpejtesise se eres sipas drejtimeve ne Durres Port




Fig.8. Trandafili i Ererave.Vendmatja Durres Port

Nga trandafili i ererave ne fig.8 vihet re se mbizoterojne ererat e sektorit Jugor kokretisht ererat e drejtimit PJ dhe J.

I.7 Lageshtia e ajrit

Avujt e ujit ndodhen ne atmosfere deri ne lartesine 6000m mbi toke.Lageshtia percakton pikerisht sasine e ketyre avujve ne ajer.Ne nje perzierje gazesh, secili gaz ushtron nje presion te pjesshem te pavarur prej atij te gazeve te tjere. Presioni i ushtruar prej avujve te ujit quhet presion i avujve.Presioni qe ushrohet nga avujt e ujit ne nje hapsire te ngopur quhet presion i avujve te ngopur ne nje temperature te dhene.Diferenca ndermjet presionit te avujve te ngopur dhe presionit aktual nje nje temperature te caktuar quhet deficit i ngopjes dhe tregon sasine e avujve te ujit per ta sjelle masen e ajrit ne kushtet e ngopjes.

Raporti mes tensionit te avujve te ujit faktit ne atmosphere dhe dhe tensioni I avujve te ngopur ne te njejten temperature quhet lageshti relative e shprehur ne perqindje.

Per matjen e klageshtise se ajrit perdoret nje instrument qe quhet psikometer I cili perbehet prej 2 termometrash:nje termometer i mbeshtjelle me nje pece te laget, i cili mat temperature e ajrit te

lagur dhe nje termometer i zakonshem qe mat temperature e ajrit te thate domethene temperature e zakoshme. Nisur nga keto te dhena per percaktimin e presionit actual perdoret formula:

$$e = e_s - 0.00066P(t_a - t_w) \left(1 + \frac{t_w}{273}\right)$$

e- presioni aktual i avujve ne mb

e_s- presioni i avujve te ngopur ne qe i korrespondon temperatures se ajrit te laget tu


P-presioni atmosferik ne mb

t_a- temperature e termometrit te thate ne ° C

t_w-temperature e termometrit te lagur ne ° C

Tabela I.7.1 Mesatarja mujore e lageshtise se ajrit Tirane

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes.
Tirane	74	72	71	72	71	66	62	63	70	73	76	76	70



2.Lumi Erzen

2.1.Vecorit Hidrografike dhe Hidrologjike te Lumit Erzen

Ky studim është i përqëndruar në zonën e përfshirë në ujëmbledhësin e lumit Erzen, i cili shtrihet nga zonat malore në lindje dhe në jug të Tiranës deri në kodrat perëndimore dhe fushore përgjatë bregut të Adriatikut, midis Tiranës dhe Durrësit, dy qytetet më të mëdha në Shqipëri.

Ky studim është i përqëndruar në zonën e përfshirë në ujëmbledhësin e lumit Erzen, i cili shtrihet nga zonat malore në lindje dhe në jug të Tiranës deri në kodrat perëndimore dhe fushore përgjatë bregut të Adriatikut, midis Tiranës dhe Durrësit, dy qytetet më të mëdha në Shqipëri.




Figura 1: Harta e baseneve kryesor lumore te Shqiperise dhe pellgu ujembledhes i Lumit Erzen

Lumi Erzen shtrihet nga zona e Gurakuqit me një lartësi prej 1300 m mbi nivelin e detit deri në detin Adriatik në Gjirin e Lalzit pranë Durrësit. Pellgu i lumit Erzen mbulon një sipërfaqe prej rreth 760 km², me një gjatësi të përgjithshme të linjes kryesore rreth 110 km dhe një lartësi mesatare te pellgut në rreth 440 m mbi nivelin e detit. Në menyre konvencionale lumi Erzen klasifikohet zakonisht së bashku me lumin Ishëm në të njëjtin pellg, qe është një nga gjashtë ujembledhesat kryesore te lumenjeve të Shqipërisë.

Pjerrësia mesatare e shtratit të lumit është rreth 0,6% ndërsa pjerrësia mesatare e bankinave te lumit është rreth 2,6%. Lumit Erzen në pjesën e sipërme ka karakteristikat e nje lumi malor me intensitet më të lartë të rrjedhës, ndërsa pas ngushticën Skorana, lumi kalon në një zonë kodrinore dhe fushore deri në derdhjen e saj në det. Në pjesën e sipërme të Erzenit, ku ka një reliev të pjerrta, shtrati i lumit është i ngushtë dhe me një pjerrësi të madhe të lumit.

Diametrat e gurëve të lumit arrin 1 m dhe më shume. Pas kryqëzimit me degën e parë malore me lumin Erzen, diametri i gurëve reduktohet në 20-30 cm. Pas kalimit të ngushticën Skorana, gurët lumore kanë diametra e 60-10 cm dhe depozitimet ranore bëhet evidente.

Regjimi lumor i ujit është tipike mesdhetare, karakterizuar nga një regjim shumë i ndryshueshem me derdhje maksimale në dimër dhe në verë minimale. Si vecori e përgjithshme, do të veconim vleren e shkarkimit kryesor vjetor të pjesës së poshtme të lumit Erzen, qe është rreth 15-20 m³/sec, qe i korrespondon një shkarkimi specifike prej rreth 20 l/sec/km². Shkarkimi maksimale i regjistruar ndonjëherë është rreth 960 m³/sec në Ndroq (1966) dhe 1100 m³/sec në Sallmonaj (1966), ndërsa minimalja mund të jetë më e ulët se 1 m³/sec.

Ujërat e lumit Erzen janë me mineralizim të ulët, te tipit bikarbonat-kalcium. Mineralizimi mesatare i përgjithshem i lumit Erzen eshte rreth 300-350 mg / l. Zona e studimit është vendosur në një pjesë të vendit e ndikuar shumë nga aktivitetet njerëzore, e karakterizuar nga një dendësi e larte e popullsisë, përqendrimi i prodhimit industrial dhe një bujqësi intensive, veçanërisht në zonat më të zhvilluara në mes të Tiranës dhe Durrësit, si dhe një pjesë e zonën bregdetare, me perspektiva të mira për zhvillimin e turizmit.

2.2 Vecorite Klimatike te Pellgut te Lumit Erzen

Pellgu i lumit Erzen, megjithatë ka një sipërfaqe të vogël, e vendosur në zona të ndryshme klimatike për shkak të formës së tij, të zgjatur nga lindja në perëndim. Zonat klimatike evidente në këtë rajon janë: të ultësirës mesdhetare (nga gryk derdhja e Erzenit deri në zonën e Mullet), klima mesdhetare kodrinore (e cila shtrihet deri në zonën e Killojkës), dhe e klimes mesdhetare para-malore (qe shtrihen nga Killojka deri në burimet Erzenit në zonën Shëngjergjit). Një pjesë e këtyre veqorive janë shqyrtuar dhe janë analizuar me siper për Tiranën dhe nuk është e arsyeshme të rianalizojmë.

Parametrat mesatar klimatik janë në vlera relativisht të krahasueshme me ato të parametrave kryesor vjetor të temperaturës dhe rreshjeve, me dallime të vogla në lidhje me madhësinë. Si një vecori e përgjithshme, temperatura kryesore vjetore dhe vlerat e rreshjeve kryesore vjetore në zonën bregdetare, kodrinore dhe atë malore janë, përkatësisht, 16°C në 1000 mm, 14°C në 1500 mm dhe 12-13°C në 2000-2500 mm. Vlerat minimale dhe maksimale të rreshjeve janë, përkatësisht, për zonën bregdetare rreth 640 mm dhe 1540 mm, për zonën kodrinore rreth 850 mm dhe 1670 mm dhe për zonën malore rreth 970 mm dhe 3500 mm.

2.3 Vecorit Hidrogeologjike

Ujrat sipërfaqësore

Nga kënd vështrimi hidrogeologjik, pellgu i uje mbledhës i Lumit Erzen karakterizohet nga ndryshime të ndjeshme, që është rrjedhojë e kapaciteteve të ndryshme uje mbajtëse të formacioneve (bazuar në litologjinë e tyre), si dhe kushteve tektonike të kompleksë që ka të bëjë me kushte të ndryshme hidromekanike dhe hidronamike të shtresave ujembajtëse. Shtresat ujembajtëse shtrihen në gjashtë zona hidrogeologjike, karakteristikat e të cilave janë evidentuar në bazë të literaturës teknike ekzistuese:

- *Zona e Malit me Gropa* përbehet nga Triassic limestone në të cilat gjenden burime të mëdha me cilësi të mirë të ujerave.
- *Zona e Krastes*, përbehet kryesisht nga formacione flishore, shumë të varfër në ujë në tokësor, me pak burime të rëndësishme nga disa formacione gelqeror.
- *Zona e Dajtit* përbehet kryesisht nga Cretaceous dolomites dhe shtresa të Paleocene limestone, nga ku burojnë sasi të konsiderueshme uje.
- *Zona e Tiranës* përfaqëson një basen malor artesian të madhë, ku dallohen tre sisteme ujor në tokësor: Cretaceous-Paleocene, që ka të bëjë me strukturë të thella që përmbajnë vlera të larta të mineralizimit të ujerave në tokësor; Tortonian, që përbehet kryesisht nga shtresa ranorshkembore të ndërthurura me shtresa argjiloshkembore dhe përmbajnë sasi të vogla të ujerave në tokësor me parametra të ndryshueshmë të komponenteve kimik; Quaternary që përbehet kryesisht nga zhavorë apo shtresa zhavoro-argjilore të shtrira në një plan, përgjithësisht me sasi të konsiderueshme të ujerave në tokësor të një cilësie të mirë.
- *Zona e Erzenit*, gjithashtu përfaqëson një pellg artesian që në përgjithësi përbehet nga ujë në një cilësi të dobët dhe të ndryshueshme, kryesisht në formacionet Pliocene konglomeratik-ranorshkembor në depozitat zhavorore të Quaternarit.




Figura 1: Pamje e hartes topografike (formati GIS) i basinit te lumit Erzen me informacionin baze shtresesor




Figura 2: Pamje e hartes dixhitale te elementeve baze

Përveç hartes topografike te pershkruar me larte, jane perdorur dhe hartat gjeologjike dhe hidrogeologjike të pellgut të lumit te marra nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar. Dy pamje te

hartave gjeologjike dhe hidrogjeologjike dhe legjendat te lidhur janë raportuar në figurat 3-3, vetëm për referencë. Të dhënat kryesore qe permbajne këto harta, përveç atyre gjeologjike, karakteristikave strukturore dhe lithostratigrafise se zonës, është dhene edhe klasifikimi hidrogjeologjike i formacioneve dhe pikat lidhese dhe informatacioni I pergjitheshem, sic jane vendodhja dhe karakteristikat bazë të burimeve dhe të puseve, shperndarja e linjave te izoipseve, e kështu me radhë.




Figura 3: Pamje e hartes gjeologjike te basenit te lumit Erzen

alQb ₂	Kuaternar, holocen i vonshem, aluvione te shtratit, zhavore, rera, alevrite	Kufi gjeologjik
alQp ₃	Kuaternar, pleistocen, aluvione te terraces se dyte, alevrite, rera, konglomerate	Kufi litologjik
alQp ₃	Kuaternar, pleistocen-holocen, koluvione, deluvione, proluvione, alevrite, rera, copa	Prishje tektonike
N ₁ t(b)	Tortonian. Argjila alevrolite, ranore, qymyre Formacioni Skuterra	Kufi transgresiv
N ₁ t(a)	Tortonian. Gelqeror litotamnike, gelqeror Formacioni Priska	Reper litologjik
N ₁ s	Seravalian. Argjila, ranore, gelqerore litotamnike	Elemente te shtruarjes normale te shtresave a) Renie te buta (0° - 30°); b) Renie mesatare (30° - 60°); c) Renie e forte (60° - 90°)
N ₁ l(b)	Langian: Argjila mergelore, gelqerore mergelore	Profil gjeologjik
N ₁ l(a)	Langian. Ranore gelqerore, mergele, argjila mergelore	Argjila
N ₁ b(d)	Burdigalian. Mergel, mergele argjilore, ranore gelqerore litotamnike vidhsore	Alevrolite
N ₁ b(c)	Burdigalian. Ranore mergel, argjila mergelore, gelqerore	Ranore
N ₁ b(b)	Burdigalian. Mergel, argjila gelqerore	Kanal ranorik
N ₁ b(a)	Burdigalian. Argjila, ranore, mergele	Konglomerate
N ₁ a(b)	Akujtianian. Flish i holle, argjila me ranore te ralle	Mergel
N ₁ a(a)	Akujtianian. Argjila konglomerate	Gelqerore litotamnike
Pg ₃ (c)	Oligocen. Flish i holle argjilorr me ranore te ralle	Gelqerore
Pg ₃ (b)	Oligocen. Flish i holle argjilo ranore me horizonte vidhsise e olistolite gelqerore e konglomerate	Ndryshim facial
Pg ₃ (a)	Oligocen. Flish i holle argjilo - ranore	Makrofauna
Pg ₃	Oligocen. Flish i holle, argjilo - ranore me ndonje horizont vidhsise te ralle	

Figura 4: Legjenda e hartes gjeologjike te basenit te lumit Erzen




























Figura 5: Pamje e hartes hidrogeologjike te basenit te lumit Erzen

	alQh ₂	Kuaternar, Holocen i vonshem, aluvione te shtrait, zhavore, rera, alevrite.
	alQp ₃	Kuaternar, Pleistocen, aluvione te taraces se dyte, alevrite, rera, zhavore.
	c Qp ₃	Kuaternar, Pleistocen, koluvione te shpatit, Brekcie, popla, argjila te kuqe.
	N ₁ ³ t(c)	Tortonian, molase, ranore shtrese trashë, argjila, alevrolite. Formacioni Iba.
	N ₁ ³ t(b)	Tortonian, molase, Argjila, aluvrolite, ranore me shtresa dhe reshpe qymyrore. Formacioni "Skuterra".
	N ₁ ³ t(a)	Tortonian, molase, Gelqerore litotamnike, gelqerore ranonike, ranore, brekçe, Ne baze boksite.
	N ₁ ² s(b)	Seravalian, Formacioni Krraba, ranore karbonatike, gelqerore ranorik, gelqerore litotamnike, alevrolite.
	N ₁ ² s(a)	Seravalian, Formacioni "Mamli", Alevrite, argjila konglomeratë, ranore, ranore karbonatikë, argjila karbonatike, Kristale gipsi.
	N ₁ ² l(b)	Langian, Argjila, argjila mergelore, gelqerore mergelore.
	N ₁ ² l(a)	Langian, Ranore, gelqerorë, mergele, argjila mergelorë.
	N ₁ ² l(b)	Burdigalian, Mergele, argjila mergelore, vihisese, konglomerate.
	N ₁ ¹ b(a)	Burdigalian, Argjila karbonatike, ranore konglomerate.
	N ₁ ¹ a(c)	Akuitanian. Argjila, argjila karbonatike.
	N ₁ ¹ a(b)	Akuitanian. Argjila me ndershtresa te rralla ranore.
	N ₁ ¹ a(a)	Akuitanian. Argjila konglomerate.
	Pg ₃ ³	Oligocen i siperm. Flish i hollë argjilorë.
	Pg ₃ ¹ (b)	Oligocen i poshtem. Flish argjilo-alevrolite-ranorik, me ranore shtrese trashë.
	Pg ₃ ¹ (a)	Oligocen i poshtem. Flish argjilo-alevrolito-ranorik.
	Pg ₃ ¹ (pk)	Oligocen i poshtem, Pakoja kalimtare, Mergela, argjila margelore.
	Pg ₂	Eocen, Gelqerore numulitike shtresore me boksider ne baze.
	Pg ₁	Paleocen, Gelqerore shtrese - trashë.
	Cr ₂	Kretak i siperm, Dolomite, gelqerore dolomitike, dolomite.
		Kufi gjeologjik.

A -Klasifikimi hidrogeologjik


1- Ne shkembinj te shkruft

Me ujembajtje mesatare


	alQh ₂ , alQp ₃	T = 500 - 100 m ² /d
	Zhavore, rera:	q = 4 - 5 l/s/m
		Q = 5 - 7 l/s

2- Ne shkembinj kompakte


Me ujembajtje te ulet

	N ₁ ³ t(b)	Ndershtresa ranoresh alevrolitik	q = 0.01-0.02
			Q = 0.1-0.3


Me ujembajtje mesatare + e ulet

	N ₁ ³ t(a), N ₁ ³ t(b), N ₁ ³ t(c), N ₁ ² l(a), N ₁ ² s(b),	Q = 0.3-2
	Ndershtresa ranoresh masive, te mesem e te trashë, ranore mergelore, gelqerore	

Me ujembajtje mesatare jo uniforme

	Pg ₁ , Pg ₂ , Cr ₂	Q = 5-20 l/sek
	Gelqerore numulitike shtresore te trashë, dolomite	

3- Ne shkembinj praktikisht pa uje

	c Qp ₃ , N ₁ ¹ (a+b+c), Pg ₃ ³ , Pg ₃ ¹ (a+b)
	Subargjila, flishë te holla argjilo - alevrolitore Alevrolite dhe mergele




Figura 6: Legjenda e hartes hidrogeologjike te basenit te lumit Erzen

Analizimi dhe perpunimi i parametrave kryesor meteorologjik dhe klimatik

Në mënyrë që të evidentohen karakteristikat klimatike të zonës, është e nevojshme një seri 30-vjeçare (1961-1990) të dhënash meteorologjike të cilat ishin në Institutin e Ujit, Energjisë dhe Mjedisit (ish-Instituti i Hidro-Meteorologic). Në tabelën në vijim janë listuar të gjitha stacionet meteorologjike të monitorimit brenda pellgut të lumit Erzen (ose prane tij). Për çdo stacion janë dhënë vlera mesatare e parametrave kryesor klimatik (nga mesataret shumëvjeçar). Tirana, Durrësi, Sukthi dhe Kamëza janë stacionet me të dhënat më të shumta përfshirë dhe ato historike. Në tabelat dhe grafiket në vazhdim, janë dhënë në detaje seria e matjeve mujore për disa parametra por jo për çdo parametër kjo për faktin se një pjesë e të dhënave meteorologjike janë shqyrtuar dhe analizuar më sipër duke iu referuar stacionit të Tiranës. Të dhënat në dispozicion meteorologjike dhe klimatike janë marrë nga Institucionet e përmendura shqiptare. Mbulimi kohor i këtyre të dhënave në përgjithësi ka të bëjë me periudhën prej '60-s për të '90-s. Të gjithë të dhënat meteorologjike (numri i ditëve me diell dhe me re, rrezatimi global, temperatura e ajrit, temperatura e tokës, rreshje, lagështia e ajrit, presioni i avullit, shpejtësia e erës, avullimi) janë të përfshira dhe të organizuar në tabelat dhe grafiket që tregojnë ecurinë mesatare mujore dhe vjetore.

Tabelat dhe grafiket e dhena permbajne perpunime komplekse te vlerave mesatare te parametrave kryesor meteorologjik.

Në Tabelën e te dhenave te pergjitheshme 9, jane te dhenat e te 18 stacionet meteorologjike (te ndodhura në brendësi të pellgut të lumit Erzen, ose në degezimet aty prane).

Tabela 1: Stacionet meteorologjike dhe te dhenat e permbledhura

Emri	Koordinata X	Koordinata Y	Lartësia	Lageshtia e Ajrit (%)	Temperatura e ajrit (°C)	Presioni i Avullit (mb)	Dite me re	Avullimi (mm)	Rreshjet (mm)	Radiacioni (cal/cm ² month)	Temperature e tokes deri ne 20 cm (°C)	Dite me diell	Shpejtesia e erez (km/h)
Krrabe	19.9714	41.216	430		13.9				1,499.50				
Sukth	19.5378	41.381	14	75.3	14.9	13.6	74.8	75.6	1,045.80		18.1	125.4	7.4
Xhafzotaj	19.5475	41.344	19		14.6				1,140.60				
Tirane	19.78	41.33	84	70.1	15.2	12.5	97.8	77	1,219.20	4,058.40	17.6	106	1.5
Kllojke	20.0197	41.269	664						1,563.30				
Bizev	20.1981	41.341	1260						1,744.30				
Selite e Malite	19.9947	41.397	751						1,943.50				
Petrole	19.8553	41.254	311						1,210.10				
Ndroq	19.6558	41.264	84						1,233.20				
Durres	19.44	41.32	73		16.1		84.4	90	931.1			115	
Dajt	19.9158	41.394	705		13				1,777.00				
Shengjergj	20.0944	41.331	752						2,249.30				
Kamez	19.7744	41.36	93	73.9	15	13.1	86.9		1,185.70		17.9	100	
Mamurras	19.6922	41.578	28		14.9								
Kruje	19.7906	41.512	491		13.6				1,628.20				
Larushk	19.7278	41.451	35		14.7				1,292.70				
Likmetaj	19.5906	41.549	155						1,064.80				
Zall Mener	19.8983	41.453	283						2,018.10				

Pershkrimi hidrografik, mbuleses se tokes dhe karakteristikat gjeologjike te lidhura me hidrologjin e basenit lumor

Baseni i lumit Erzen mbulon nje siperfaqe rreth 760 km², me nje gjatesi totale te drejtimit kryesor ne rreth 110 km dhe nje lartesi te pellgut ne rreth 440 m mbi nivelin e detit.

Simbolikisht, bazuar ne morfologji, rrjedha lumore mund te ndahet ne tre seksione:

- Seksioni i siperm i Erzenit (zona malore), nga burrimi (ne fshatin Shengjergj) posht ne fshatin Ibë (fshati Ibë eshte disa Km poshte grykes se Skoranes, ku eshte ndertuar nje dige e vogel net e kaluaren);
- Seksioni i mesem i Erzenit (mesi i lugines), skematikisht nga fshati Ibë deri ne fshatin Ndroq;
- Seksioni i poshtem i Erzeni (zona e poshtme fushore), nga fshati Ndroq ne detin Adriatik (Plazhi i Lalzit), pershkone fushen e gjere midis Tiranes dhe Durrësit.

Poshtë digës se Skoranes ka shkarkime të perroit te Zallit në të majtë, si dhe perroit te Farkës në të djathtë. Në pellgun ujëmbledhës të kësaj të fundit, janë ndërtuar disa rezervuar uJOR.

Perrenjte e Zarranikes, Zhellimes dhe Pezes derdhen në lumin Erzen nga zonat kodrinore pergjate bankines se majtë, ndërsa nga bankina e djathte merr uje kanali i Tanes.

Morfometria

Gjatësia e rrjedhes dhe sipërfaqja e zonës ujëmbledhës duhet të përmenden si një nga karakteristikat më të rëndësishme morfometrike të një rrjeti lumor. Për shkak të karakteristika fiziko-gjeografike të sipërfaqes ujëmbledhës (dallime të mëdha në lartësi), lartësia baze e sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës është e një rëndësie të vecant.

Lumi Erzen rrjedh tërësisht në territorin e Shqipërisë (110 km). Erzeni përbëhet nga 5 përrenj të rëndësishëm me pellgje ujëmbledhese që variojnë ndërmjet 34,4 km² dhe 132 km². Duke u përqendruar vetëm në pjesë qendrore të rrjedhes lumore, është e qartë se ajo ka qenë formuar kohët e fundit, edhe pse më tej në drejtim të rrymës, ajo ka një profil të ekuilibruar.

Pjerresia e shtratit të lumit në rrjedhën e poshtme është e butë në krahasim me rrjedhën e sipërme, në mal. Pra, do të thotë se pjerresia e shtratit të lumit Erzen në mes të burimit dhe të grykës së Skoranes është 40%, në Ndroq ajo zvogëlohet në 13%, duke rënë në 6% pranë grykës derdhjes në detin Adriatik.

Analizimi i territorit nga kënd vështrimi orografik dhe gjeologjik, mund të dallohen disa lloje të ndryshme të profilit transversal të luginës së lumit.

Rrjedhja për gjatë luginës së lumit, lumi është shumë i thyer dhe merr formën "V".

Profili trapezoidal dhe asimetric janë karakteristike të zonës kodrinore. Kjo është për shkak dhe të terracave në zone. Profili transversal i zonës paraqet një trapez me një bazë të madhe. Kjo përfaqëson një zonë të mbushur, sidomos pjesët e ulta të Erzenit. Në këtë zonë, brigjet e lumit janë shumë të larta. Terracat e lumit janë mjaft të gjerë, duke arritur në disa vende deri në 0,5 km. Lumi ka një rrjet hidrografik të shtrirë (me prerje horizontale), me një koeficient 2.1 km/km².

Prerja horizontale shkon nga 0.1-0.2 në zonën fushore në 4-5 km/km² në zonën malore. Zona e sipërme të pellgut ujëmbledhës ka një reliev shumë të thyer me burime uji të shumta atje ku gelqeroret janë në kontakt me fliшет.

Energjia e relievit, e cila përfaqëson rritjen e lartësisë (m) për çdo km, varon nga zero në zonën fushore deri në 400-500 m në zonën e sipërme të rrjedhes.

Nga analiza e kurbës hizometrike evidentohet që 75-90% e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi i takon një lartësie prej 200 m mbi nivelin e detit.

Relievi, gjeologjia dhe mbulesa bimore

Relievi ndikon në regjimin e rrjedhjes në dy drejtime, përmes pjerresisë së shpatëve të vete lumit, dhe në mënyrë indirekte, përmes ndryshimit të lartësisë të elementeve klimatike të cilat formojnë rrjedhën.

Pellgu ujëmbledhës i Erzenit konsiston në 31% në zonë fushore (nën 200 m m.s.l.), 53% në zonë kodrinore (lartësia midis 200-800 m), dhe 16% në zonë malore.

Pjesa e poshtme e pellgut ujëmbledhës përbëhet nga fushat e Tiranë-Shijak-Durrës. Nuk ka kushte të favorshme për formimin e rrjedhës në këtë zonë, për shkak të pjerresive të butë. Kjo situatë shkakton filtrimin dhe avullimin e një sasive të madhe të rreshjeve që bien mbi këtë sipërfaqe. Pra, në periudhën e ngrohtë të vitit, rrjeti hidrografik është i thatë ose me një rrjedhje të varfër.

Zona kodrinore (200-800m) shtrihet kryesisht mbi pjesën qendrore të këtij territori, siç janë zonat kodrinore në shpatet perëndimore dhe lindore të malit të Dajtit dhe varg maleve të Krrabes. Karakteristike e kësaj zone janë format e rrumbullaketa të relievit. Kushtet e formimit të rrjedhjes në këtë zonë janë më të favorshme se në ato të ulët.

Regjimi malor i rrjedhjes (niveli i zonës ujëmbledhës është mbi 800 m) është e përfaqësuar nga rajoni i Malit me gropa. Ku ka kushte shumë të favorshme për formimin e rrjedhës në këtë zonë, që dallohen jo vetëm nga pjerësia e madhe e relievit, por edhe nga një sasi më e madhe e rreshjeve në krahasim me zonat e tjera. Favorizohet nga temperaturat e uleta të, bora është karakteristikë për shumicën e këtyre zonave, të cilat janë të vlefshme për pasurimin e burimeve ujore, të cilat kanë origjinën e tyre në territoret e larta karstike, siç është burrimi i Shenmeris, burimi me i rendesishëm brenda pellgut të lumit Erzen.

Toka

Për shkak të ndryshimeve të mëdha në faktorët pedogjenik, dhe veçanërisht nga relievi, si dhe të mbulesës bimore dhe të klimës, territori hidrografik i Erzenit ka një larmishmëri dhe mbulesë tokësore të pasur.

Dallohen tipet në vazhdim të tokës:

- Në zonat malore, ka shtresa karbonatike-humus me gjerësi të vogël mbi shkëmbinj gëlqerorë (Mali me gropa). Uji penetron lehtësisht ndërmjet tyre, dhe kur arrijnë në shkëmbinj gëlqerorë bazë, ajo depërton nëpër të çara dhe shërben si një burim i fuqishëm i ujërave të nëntokës, duke formuar një karakteristikë të veçantë të rrjetit hidrografik të zonave karstike.

- Në zgjerimet pranë livadheve malore, ka rripa tokë të errëta gri dhe gri-kafë. Karakteristika kryesore e këtyre tokave është aftësia e tyre për të grumbulluar ujë, sidomos në periudhën e ngrohtë të vitit, ku infiltrimi është në shtresat argjilore të tokës është i lehtë. Kështu, kjo rrit rrjedhjen e ujit të rrjetit nëntokësor. Në dimër dhe pranverë, për shkak të niveleve të larta të lagështisë, këto toka janë më pak të depërtueshëm, kështu që ato kanë një ndikim më të madh në të ushqyerit e sipërfaqes së rrjetit hidrografik.

Tokat-gri të errët, të cilat janë formuar mbi shtresat argjilore nën livadhet malore kanë një koeficient të ulët infiltrimit edhe gjatë rrebesheve. Gjatë periudhës së nxehtë të vitit, perrenjtë që derdhet mbi këto toka janë të thata. Shtresa ngjyrë kafë dhe gri-kafë të tokës shtrihen në zonat gri-kafë. Në përgjithësi, ato janë të formimit të njëjtë dhe shtrihen në të njëjtën thellësi si zonat ujëmbledhëse ngjitur. Në zonën bregdetare ka tokë aluviale kripur. Brigjet e lumit janë formuar në shtresa. Tokat janë ranore dhe argjilore (me rërë lumi). Tokat ndikojnë keq në rrjedhjen e lumit, për shkak të aftësisë së gjireve lumore dhe pjerrësisë së vogël.

Mbulesa bimore

Në lidhje të ngushtë me elementet klimatike dhe ato te tokes, bimësia paraqet një model të dukshem vertikale të shpërndarjes se saj.

Në zonën e ahut, ku mbizoterojnë haloret, ndikimi i pyllit është ndjerë gjatë gjithë vitit. Në periudhën midis Prillit dhe Tetorit, të pasura me reshje, nuk janë vetëm kurorat e pemëve që mbajnë ujë, por edhe gjethet te rena mbajnë një sasi të madhe të rreshjeve. Kështu, koeficientet e rrjedhjes maksimale janë më të ulëta për territorin brenda pyll.

Në pranverë, që bora shkrihet ngadalshëm në zonën e pyjeve, rrjedhja maksimale është më e ulët se sa në ato të tjera. Duhet vënë në dukje se pyjet pengojnë erozionin dhe derdhet e shpejta të rrëkeve në terrenet shumë të pjerrta. Në zonën malore (1000-1700 m mbi msl), ku ndodhet zona fitoklimatic (gjethet e pyjeve janë përhapur), ndikimi i pyllit është më i rëndësishme gjatë periudhës së vegetacionit, sepse e mbane të bllokuar një sasi të konsiderueshme rreshjesh në tokë . Pyjet gështenjë (800-1200m), kanë të njëjtin efekt.

Në përgjithësi, në zonat me shkallë të lartë pyllëzime, pasojat e tjera të ndikimit të pyjeve në rrjedhën e regjimit të lumit janë vërtet, të tilla si: rritja e të ushqyerit të burimeve nëntokësore, ruajtjen lagështi apo uljen e avullimit nga sipërfaqja e tokës (për shkak të fenomenit hije).

Shkuret e përhapura fitoklimatic në lartësin 500 m mbi nivelin e detit. Kjo zonë luan një rol të rëndësishëm në uljen e plotes torrenciale në rrjetin hidrografik.

Në rastet kur shkurret mungojnë në zonë, pasojë do të jetë një rrjedhë torrenciale dhe erozion të shpateve, kështu që forrimi i rrjedhjes baze është zbutur. Pyjet ushtrojnë e kështu efektet e përmendura më sipër të tyre pozitive dhe negative në zonat e uleta.

Ndikimi i bujqësisë në rrjedhën e lumit në këtë zonë varet nga zhvillimi i metodave të kultivimit të tokës. Tokat e kultivuara ndikojnë në rrjedhën e lumit duke mbledhur dhe ruajtur ujin e rreshjeve, veçanërisht gjatë periudhave të thata. Pyjet perbejnë rreth 37% të sipërfaqes ujëmbledhës të Erzenit.

Gjeologjia

Modeli gjeologjik është i një rëndësie të veçantë nga kënd vështrimit hidrologjike, sepse kjo shkakton mbledhjen e ujërave freatik të nëntokës, e cila shërben si një burim ushqimi për lumenjtë në periudha të ndryshme të vitit.

Erzeni ka origjinën e saj në zonën ku Mirdita vjen terthor me Krasten dhe pjesërisht në depozitimet fundore të tij.

Në zonën ujëmbledhëse të Erzenit, në veri të Krabes, ka gëlqeror Cretaceous dhe pjesërisht depozitime ranoro-argjilore të Tortonianit në drejtim të rrjedhës. Pranë Ndroqit, shkëmbinjtë argjilore-ranore-karbonatik të Neogene mund të gjenden dhe në pjesën e poshtme ku ka depozita të kuaternarit.

Analiza e te dhenave hidraulike nga stacionet hidrologjike dhe pikat monitoruese te siperfaqes se ujit

Të dhënat hidraulikë dhe të cilësisë së ujit në dispozicion të stacioneve hidrologjike dhe të pikave të monitorimit të sipërfaqes së ujit janë marrë nga Institucionet e përmendura. Mbulimi kohor i këtyre të dhënave në përgjithësi ka të bëjë me periudhën prej '60-s për të '90-s. Të gjithë të dhënat meteorologjike (numri i ditëve me diell dhe me re, rrezatimi global, temperatura e ajrit, temperatura e tokës, rreshje, lagështia e ajrit, presioni i avullit, shpejtësia e erës, avullimi) janë të përfshira dhe të organizuar në Geodatabase / GIS në seksionin A "Stacionet Meteorologjike", kështu që është e mundur për të kryer analiza të gjera hapësinore dhe kohore, si dhe përpunime. Për më tepër, është e mundur për të operuar me elementet grafik që i përkasin asaj kategorie të përfshira në programin GIS në mënyrë që të lidhet me tabelat dhe grafikët respektive.

Tabelat dhe grafikët e dhëna përmbajnë përpunime komplekse të vlerave mesatare të parametrave kryesor meteorologjik.

Në Tabelën e të dhënave të përgjithshme 1, janë të dhënat e të 18 stacionet meteorologjike (të ndodhura në brendësi të pellgut të lumit Erzen, ose në degezimet aty pranë). Për çdo stacion, janë demonstruar të dhënat e përgjithshme (koordinatat X dhe Y, lartësia mbi nivelin e detit), së bashku me vlerat mesatare vjetor të parametrave klimatik të analizuar.

Tabelat dhe grafikët e dhënë në vazhdim përmbajnë përpunime komplekse të vlerave baze mesatare të rrjedhjeve ujore dhe të parametrave kryesor të cilësisë së ujit. Në tabelën 2 janë dhënë përmbledhja e matjeve të 18 stacioneve të ujerave sipërfaqësore (kryesisht të vendosura përgjatë rrjedhës së Erzenit dhe në disa raste, në disa degëzime të vogla). Për çdo stacion, janë të treguara të dhënat e përgjithshme (koordinatat X dhe Y, lartësia mbi nivelin e detit, emrin e ujëmbledhës-dytestor të zonës) së bashku me vlerat mesatare vjetore të rrjedhës së ujit dhe parametrat e analizuar të cilësisë së ujit.

Tabela 2: Stacionet hidrologjike dhe pikat monitoruese të ujerave sipërfaqësore në basenin e Lumit Erzen – Të dhënat e Përmbledhura

